

Informatat mbi Projektin

Emri i Projektit:	“Të rinjtë - vullnetarë për ndryshim pozitiv”
Vlera e projektit:	Shuma e përgjithëshme: € 14,997.49
Kohëzgjatja:	Fillimi: 01/11/2019 Përfundimi: 30/04/2020
Organizata implementuese:	Qendra për Hulumtime Psiko-Sociale dhe Mjekësore
Kontaktet e Organizatës: Adresa, e-maili, telefonat.	Rruga C, Hyrja 1. Kati 3, Nr. 8 +383 45 111 355 https://qhpsm.net
Grupet e synuara:	Ky projekt, ka për qëllim fuqizimin e të rinjëve, nëpërmjet ofrimit të një dëshmie konkrete për fuqinë që kanë për ndryshime përmes aktiviteteve të tyre vullnetare dhe jashtë-kurrikulare.
Partnerët:	Nuk ka.
Territori i synuar/shtrirja gjeografike:	Projekti do të realizohet në gjashtë komuna: Kamenicë, Kaçanik, Obiliq, Hani i Elezit, Lipjan, Shtime
Qëllimi i përgjithshëm:	Projekti ka për qëllim, që të përfshijë të rinjtë në identifikimin e kauzave sociale relevante për komunën ku jetojnë, të analizojnë dhe zbërthejnë në detaje problemin që e përcjellë kauzën, dizajnimin dhe realizimin e aktiviteteve vullnetare për adresim të këtyre problemeve dhe përmbushje të kauzave. Pra, i tërë projekti udhëhiqet nga perceptimi që kanë të rinjtë për kauzat relevante sociale dhe vizioni i tyre për adresimin e kauzave të tilla. Projekti ka për qëllim, që të pajis të rinjtë me shkathtësi dhe kompetenca për të kuptuar, analizuar dhe adresuar probleme të ndryshme sociale në komunitetin në të cilin jetojnë. Për më tepër, projekti synon që të përfshijë të rinjtë në aktivitete vullnetare dhe jashtë-kurrikulare, nga të cilat ka dobi të përgjithshme sociale.
Aktivitetet kryesore:	Thirrja për rekrutim të të rinjëve nga 6 komunat e përzgjedhura për implementim të projektit Takimi i të rinjëve dhe krijimi i grupeve në 6 komuna (18 grupe gjithsejt) Trajnim për fuqizimin e rolit të të rinjëve në ndryshime pozitive sociale (6 trajnime në 6 komuna) Grupet identifikojnë kauzat e tyre sociale Grupet bëjnë analizën dhe zberthimin e problemit Propozimi i zgjidhjeve konkrete të problemeve që konsiderohen baza e kauzave sociale Trajnimi i të rinjëve për ideim, planifikim dhe realizim të aktiviteteve vullnetare Dizajnimi i aktiviteteve vullnetare Realizimi i aktiviteteve vullnetare për avancim të kauzës që siguron adresim të problemit social Trajnimi i të rinjëve për vlerësimin e intervenimeve dhe promovimin e rezultateve Realizimi i aktiviteteve jashtë-kurrikulare për promovimin e rezultateve të aktivitetit vullnetarë Shkrimi i raporteve dhe shpërndarje e tyre
Rezultatet e pritura:	Të rinjtë aftësohen që të identifikojnë kauza të rëndësishme sociale. Të rinjtë aftësohen që të analizojnë, zberthejnë, avancojnë mendimin kritik dhe provokojnë debat në lidhje me kauzat e ndryshme sociale. Të rinjtë aftësohen dhe përgatiten që të ideojnë aktivitete vullnetare që kanë për qëllim avancimin e kauzave të caktuara sociale.

Të rinjtë realizojnë aktivitete vullnetare dhe jashtë-kurrikulare që kanë për qëllim që të avancojnë kauza të caktuara sociale.

Të rinjtë fitojnë kompetenca dhe përgatiten që të masin dhe vlerësojnë efektin e aktiviteteve të tyre vullnetare, përmirësojnë dhe avancojnë intervenimet e tyre vullnetare.

Të rinjtë përfshihen në aktivitete kreative jashtë-kurrikulare, që kanë për qëllim promovimin e rezultateve të nismave të tyre për të shtyrë përpara kauzat e caktuara sociale.